

Apostilimi i dokumenteve

Përshkrimi

Certifikimi i dokumenteve të lëshuara nga institucionet shtetërore shqiptare dhe shoqëritë private dhe që janë për përdorim jashtë vendit, konform Konventës së Hagës për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve, tetor 1961.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Dokumenti që do të legalizohet;
- 2) Letërnjoftim, nëse do të kërkohet verifikimi i identitetit;

Hapat e procedurës

- 1) Dokumenti i administratës vendore dhe institucioneve të varësisë, vërtetohet nga institucioni mbikëqyrës ose qendror;
- 2) Për dokumentet e institucioneve private, noterizohet firma e lëshuesit;
- 3) Dorëzimi i dokumentit pranë zyrave të agjentëve postarë të kontraktuar të MPJ;
- 4) Verifikimi i dokumentit të paraqitur, nëse do të jetë e nevojshme;

Tarifa e shërbimit dhe afati

- 200 lekë/dokument për shtetasit shqiptar
 - Reciprocitet për shtetasit e huaj
- 2-4 ditë pune

Zyra

Drejtoria Konsullore, Ministria e Punëve të Jashtme

Shënime

Dokumentet paraqiten vetëm pranë zyrave të agjentëve postarë, të kontraktuar nga MPJ; Posta Shqiptare, TNT dhe AC. Certifikohen dokumente origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin.

Bashkëlidhur:

Lista e vendeve, për të cilat kërkohet apostilimi i dokumenteve: [Lista e vendeve me apostilim](#)